REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 4, datë 14.10.2020

**PËR**
**NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1, DATË 26.07.2018 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT "PËR SHPALLJEN E ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË".**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 10 dhe 16 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të neneve 4, 9 dhe 28 të Ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, të neneve 30 dhe 31 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit", Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin Nr. 1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa:

   a) Në pikën 1, pas pikës 1.17, shtohet pika 1.18, me përmbajtje si më poshtë:
   *1.18: Zona e Bulevardit të Ri të Tiranës, me sipërfaqe 21953.42 $m^2$.*

   b) Dokumentacionit të përmendur në pikën 2, i shtohen dokumentet e poshtëshënuara, të cilat bëhen pjesë përbërëse e tij:

      a. *Hartat e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, zonat totale dhe zona e "Bulevardit të Ri" të Tiranës.*

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe gjithë Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit që përfshihen në këtë zonë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I R A M A**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MINISTËR I LINJËS

**BLENDI KLOSI**

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**